

VENDIM
Nr. 743, datë 3.12.2021

**PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHETËTËRORE TË SISTEMIT TË
VLERËSIMIT TË MATURËS SHETËTËRORE (SVMSH)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit të Vlerësimit të Maturës Shtetërore (SVMSH).

2. Institucioni administrues i bazës së të dhënave shtetërore të SVMSH-së është Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA).

3. Të dhënat e bazës shtetërore të SVMSH-së ndahen në të dhëna parësore dhe dytësore, si më poshtë vijon:

a) të dhëna parësore të SVMSH-së konsiderohen të dhënat e krijuara dhe të mbledhura nga QSHA-ja, që kanë të bëjnë me:

i. të dhënat që i posedon institucioni arsimor në lidhje me maurantët, të cilat hidhen në sistem nga mbikëqyrësi i shkollës, në mënyrë që të gjenerohet ID-ja unike, e cila identifikon maurantin/kandidatin në sistem, gjatë plotësimit të formularit;

ii. vlerësimin në provimet e maturës;

iii. qendrat për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore;

iv. listat e provimeve të Maturës Shtetërore;

v. përcaktimin e notave të shkallëzuara në varësi të pikëve të fituara;

b) të dhënat dytësore të SVMSH-së konsiderohen të dhënat që merren nga një bazë tjetër të dhënash, ku ato janë parësore. Të dhënat dytësore janë të dhënat që merren nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, si më poshtë vijon:

i. numri i identifikimit personal;

ii. emri, atësia, mbiemri;

iii. datëlindja e vendlindja.

4. Dhënës të informacionit për SVMSH-në janë institucionet arsimore parauniversitare, ZVAP-të, maurantët/kandidatët e çdo institucioni arsimor parauniversitar dhe ministria përgjegjëse për arsimin.

5. Subjekte për SVMSH-në janë maurantët/kandidatët, ministria përgjegjëse për arsimin, institucionet në varësi të ministrisë përgjegjëse për arsimin, të cilat nuk kanë akses në sistem.

6. Sistemi i SVMSH-së ndërvepron me bazën e të dhënave shtetërore, në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

7. Të dhënat personale të transmetuara duhet të ruhen për aq kohë sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin për të cilin janë grumbulluar.

8. Niveli i aksesimit për subjektet e interesuara për SVMSH-në përcaktohet nga aksesi i lejuar për përdoruesit e këtij sistemi. Punonjësit e autorizuar të QSHA-së kanë akses të plotë në sistem. Mbikëqyrësi, punonjës i institucionit arsimor, ka rolin e krijimit të formularëve dhe të pasurimit të databazës tek *user*-i përkatës i institucionit arsimor, duke pasur akses të kufizuar në sistem, duke u emërtuar në sistem si mbikëqyrës i formularëve. Zyrat vendore të arsimit parauniversitar kanë akses në sistem vetëm për të deklaruar mbetësit vjetorë, që raportohen nga shkollat.

9. Palët marrin masa teknike dhe organizative të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi. Çdo veprim në sistem, lidhur me aksesin,

ndryshimin, korrigjimin, përhapjen e të dhënave etj., duhet të lërë gjurmë, me qëllim garantimin e sigurisë dhe të konfidencialitetit të të dhënave.

10. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj